

20141384272

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR AUTOMJETE

Neni 1

Në ligjin për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 140/2008, 53/11, 123/12, 70/13 dhe 165/13), në nenin 21 në paragrafin (1) fjalët: "regjistri i të dhënave të automjeteve" zëvendësohet me fjalët: "regjistri i automjeteve të lejuara të tipeve dhe të veçanta, sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësive të pavarura teknike dhe pajisjeve të automjeteve në Byronë e Metrologjisë."

Neni 2

Në nenin 65 në paragrafin (2) pas alinesë 2 shtohet aline e re 3, si vijon:

" - në bazë ditore nuk i fut të gjitha të dhënat në softuerin elektronik të përcaktuar në nenin 73-a të këtij ligji,"

Neni 3

Pas nenit 73 shtohen nëntitulli i ri dhe tri nene reja 73-a, 73-b dhe 73-v, si vijojnë:

"Regjistri i automjeteve që e kanë kaluar kontrollin teknik dhe për ndjekjen e pagimeve dhe kompensimeve të cilat paguhen gjatë kontrollit teknik

Neni 73-a

(1) Ministria e Transportit dhe Lidhjeve përmes softuerit elektronik mban regjistër të automjeteve që e kanë kaluar kontrollin teknik dhe për ndjekjen e pagimeve dhe kompensimeve të cilat paguhen gjatë kontrollit teknik, i cili përmban të dhëna nga evidenca e personave juridikë të autorizuar për kontroll teknik për:

- automjete të cilat e kanë kaluar kontrollin teknik,
- kartonin personal të çdo automjeti veç e veç,
- pagesa dhe kompensime të cilat paguhen gjatë kontrollit teknik dhe
- kompensime tjera të cilat kanë të bëjnë me evidencën e automjeteve dhe ndjekjen e pagesave dhe kompensimeve.

(2) Personat e autorizuar juridikë për kontroll teknik janë të obliguar çdo që ditë të fusin të dhëna nga paragrafi (1) i këtij neni në regjistrin e automjeteve që e kanë kaluar kontrollin teknik dhe për ndjekjen e pagimeve dhe kompensimeve të cilat paguhen gjatë kontrollit teknik.

Neni 73-b

(1) Për azhurnimin e të dhënave në regjistrin nga neni 73-a i këtij ligji, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve mund të shfrytëzojë të dhëna nga evidenca e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Byrosë së Metrologjisë.

(2) Për veprim në pajtim me kompetenca e përcaktuara me ligj, qasje në të dhënat e regjistrin nga neni 73-a të këtij ligji mund të kenë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Byroja e Metrologjisë, Drejtoria e të Hyrave Publike e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë dhe Inspektorati Shtetëror i Transportit.

Neni 73-v

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve sipas nevojës mund të shkëmbejnë të dhëna dhe informata nga evidenca e regjistrave nga neni 73 dhe neni 73-a të këtij ligji."

Neni 4

Personat fizikë dhe juridikë të cilët nuk kanë dorëzuar kërkesë për regjistrimin e traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve në afatin e përcaktuar në nenin 52 paragrafi (2) të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 123/12 dhe 70/13), mund të paraqesin kërkesë për regjistrim në periudhën e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 30 qershor 2015.

Neni 5

Propozimet për legalizimin e traktorëve dhe rimorkiove të traktorëve që nuk janë dorëzuar në afatin e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 70/13) mund të dorëzohen në periudhën nga dita e hyrjes së fuqi të ligjit deri më 31 dhjetor 2014.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".